



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. i prot. 1570 Më 19.04.2023
Br. prot. Dt. 19.04.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 623-23-1752-2-3-6/C464

Emri i Autoritetit Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: GeoGroup Ing SH.P.K., Rruga Idriz Bytyqi, Sërbicë e Poshtme, 811492173, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: SHËRBIME PËR TË GJITHA MANIFESTIME E AKTIVITETEVE KULTURORE PËR VITIN 2023, SHËRBIME ME LED PROFESIONAL, ZËRIMIT DHE NDRIÇIMIT PROFESIONAL PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT – Ritenderim

Me numër identifikues: 623-23-1752-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve: Shërbime për të gjitha manifestime e aktiviteteve kulturore për vitin 2023, shërbime me led profesional, zërimin dhe ndriçimin profesional për nevojat e komunës së rahovecit – Ritenderim, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 10 Muaj

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [5] nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi për Kryerjen e Shërbimeve është: NË KOMUNËN E RAHOVECIT

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ /u lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 4,980.00 Euro;

[Katërmijë e nëntëqindetëdhjetë Euro e zero Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimi të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për... muaj, pas pranimi të shërbimeve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 11 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore


13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Operatorin Ekonomik:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Jetmir Mustafa
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.04.2023	Data:	19.04.2023
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Paramasa shërbime për manifestimet e aktiviteteve Kulturore për vitin 2023 (Shërbime me LED profesional, zërimin dhe ndriqim profesional) për nevoja të Komunës së Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Zërim për koncert dhe aktivitete kulturore, sistem analog deri në 10 mikrofona dhe 10 kanale hyrese për instrumente, DJ me 4 x 1000 W + 2 SUB Total : 6000 W Piku. 12 MAJ 2023 "Dita e Dëshmorëve"	cope	1	500.000	500.00
2	Zërim për koncert dhe aktivitete kulturore, sistem analog deri në 10 mikrofona dhe 10 kanale hyrese për instrumente, DJ me 4 x 1000 W + 2 SUB Total : 8000 W Piku. 14 Qërshor 2023 "Dita e Çlirimit të Komunës së Rahovecit"	cope	2	500.000	1,000.00
3	Zërim për koncerte dhe aktivitete kulturore, sistem analog deri në 10 mikrofona dhe 10 kanale hyrese për instrumente, DJ me 4 x 1000 W + 2 SUB Total : 6000 W Piku. "Muaji i mërgatës"	cope	3	500.000	1,500.00
4	Zërim për koncert dhe aktivitete kulturore, sistem analog deri në 10 mikrofona dhe 10 kanale hyrese për instrumente, DJ me 4 x 1000 W + 2 SUB Total : 8000 W Piku 28 Nëntor 2023 "Koncerti festiv i festave të Nëntorit"	Copë	1	500 000	500.00
5	Ndriqim për koncerte dhe aktivitete kulturore 12 x Moving Head Wash min 37x19 W, 12 Moving Head Spot min,440W, 6 x Fresnel min 2KW ose 400W LED Fresnel,2xDimmer min.6 ch (20A/ch), 1 x Laptop me Interface DMX, në qmim përfshihet kabllimi i sistemit me umx sinjal dhe energji elektrike si dhe manovrimi me paisje gjat eventit dhe kornizat mbajtëse prej alomini	cope	3	300.000	900.00
6	LED Ekran min. p4 full HD (në çmim duhet të përfshihen komplet kabllimi i sistemit, varja e tij nëse kërkohej dhe ngritja deri në 2,60m nga toka, dimensionet 4 x2 = 8m2(të parashihet sipas nevojës montimi dhe çmontimi i skenes)	cope	6	96.666	580.00
Totali:					4,980.00

